



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

EmriGjykates

Numri i lëndës: 2021:076159

Datë: 24.03.2022

Numri i dokumentit: 02837834

KML.nr.1/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen kundërvajtëse kundër të pandehurit M.C., nga fshati D., komuna L., për shkak të veprës kundërvajtëse sjellja arrogante nga neni 4 par.1 e 2 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Leposaviç - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.30/2021 të datës 09.11.2021 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Dega në Mitrovicë Ka.nr.514/2021 të datës 14.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 17.03.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET si e papranueshme kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit M.C., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Leposaviç -Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.30/2021 të datës 09.11.2021 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Dega në Mitrovicë Ka.nr.514/2021 të datës 14.01.2022.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Leposaviç - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.30/2021 të datës 09.11.2021, i pandehuri M.C. është shpallur fajtor, për veprën kundërvajtëse sjellja arrogante nga neni 4 pr.1 e 2 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike, për të cilën kundërvajtje është dënuar me dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) €, të cilën është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të pandehurin e ka obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 5 €.

Numri i lëndës: 2021:076159
Datë: 24.03.2022
Numri i dokumentit: 02837834

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës - Dega në Mitrovicë Ka.nr.514/2021 të datës 14.01.2022, është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të pandehurit ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit M.C., avokat Dragisha Krstoviç nga Leposaviçi, pa i potencuar bazat për paraqitje të kërkesës, me propozim që të aprovohet si e bazuar kërkesa, kurse aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i pandehuri të lirohet nga përgjegjësia për kundërvajtjen e cila i vihet në barrë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLK.nr.01/2022 e datës 01.03.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të hudhet si e palejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 433, 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e papranueshme.

Konform dispozitës së nenit 149 par.2 të Ligjit për Kundërvajtjet Nr.05/L-087 i datës 8 gusht 2016, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ngritët nga Prokurori i Shtetit brenda afatit prej 3 muajsh, nga dita kur aktgjykimi për kundërvajtjen ka marrë formën e prerë.

Andaj, mbrojtësi i të pandehurit, nuk ka të drejtë të paraqes kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, nga se kjo e drejtë i takon vetëm Prokurorit të Shtetit, që do të thotë se në rastin konkret kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit M.C., av. Dragisha Krstovi, me ligj nuk është e lejuar, prandaj kjo gjykatë të njëjtën e hodhi si të papranueshme dhe në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.2 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
KML.nr.1/2022, më datë 17.03.2022

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Mejreme Memaj